

# TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE NË BASHKINË PUSTEC PER VITIN 2025

*Paketa Fiskale e Bashkisë Pustec përbëhet nga :*

## **I. TAKSAT VENDORE**

1. Tatim i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël
2. Taksa mbi pasurinë e paluajtshme
  - 2.1 Taksa mbi ndërtesat
  - 2.2 Taksa mbi tokën bujqësore
  - 2.3 Taksa mbi truallin
3. Taksa e fjetjes në hotel
4. Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja
5. Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme
6. Garanci financiare për subjektet fizike/juridike, kërkues i lejes për ndërtimin, riparimin, restaurimin apo shembjen e objektit:
7. Taksa e tabelës
8. Taksa vjetore e mjeteve të përdorura

## **II. TARIFAT VENDORE**

1. Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave
2. Tarifa endriçimit
3. Tarifa për zënien e hapësirave publike
4. Tarifë tregëtimit
5. Tarifë regjistrim veprimtari Private
6. Tarifë për Liçensë /Çertifikatë në fushën e Transportit rrugor
7. Për Leja shërbimi, liçenca . autorizime (Kopetence e Bashkise)
8. Tarifa ne sektorin e ujitjes dhe kullimit
9. Tarifë e Kontrollit Veterinar
10. Tarife të ardhura nga Administrata për shërbimet
11. Tarifë nga sektori i planifikimit te teritorit
12. Tarife për peshkim amator.
13. Tarifë shërbimi për qytetarët .
14. Tarifë për dhënjë në përdorim të tubacioneve nëntokësore dhe ajrore, për shtrirjen e linjave nëntokësore dhe ajrore (telefon, energji, tv, kabllor, internet etj .
15. Tarife per te vizituar muzeun “Sterjo Spasse”

## **III. GJOBA PËR MOSSHLYERJE NË AFAT TË DETYRIMIT**

1. Mosshlyerje të detyrimeve tatimore (taksa, tarifa)
2. Llojet dhe nivelet e gjobave për shkeljet dhe kundravajtjet administrative
3. Nivel i gjobave për ndotje të hapësirës publike dhe ndotje akustike
4. Niveli i gjobave për kryerjen e aktivitetit tregëtar pa liçensë, autorizim apo leje përkatëse
5. Niveli i gjobave për dëmtimet dhe ndërhyrjet në rrjetin e ndriçimit rrugor, rrjetin e kanalizimeve dhe ujsjellësave
6. Niveli i gjobave për ndërhyrje dhe dëmtime në hapësirat egjelbërta dhe publike si dhe fasadat

- 7.Niveli i gjobave për inspektoriatin veterinar
- 8.Niveli i gjobave në sektorin e bujqësisë, pyjores dhe bordin e kullimit
- 9.Niveli i gjobës për përdorimin e pa autorizuar të logos së Bashkisë Pustec
- 10.Niveli i gjobës për dëmtime të objekteve të rëndësishme të veçantë

#### **IV. TË ARDHURA JO TATIMORE**

- 1.Të ardhura nga dhënia me qira e aseteve në pronësi të Bashkisë
- 2.Të ardhura nga sekuestime dhe zhdëmtime
- 3.Të ardhura nga shitja e mallrave dhe e shërbimeve
- 4.Të ardhura nga shitja e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara

#### **TE DHENA E PERDORIMIT TE TOKES NE TERRITORIN E BASHKISË PUSTEC**

Territori i Bashkisë Pustec shtrihet në një sipërfaqe prej 19.800ha.

Zonat e përdorimit sipas funksioneve kryesore baze janë:

1. Zona urbane, sipërfaqja 1.55 ha, 1.32% e sipërfaqes të territorit të Bashkisë.
2. Zona bujqësore, sipërfaqja 1405 ha, 14% e sipërfaqes së territorit të Bashkisë.
3. Zona natyrore pyje kullota, sipërfaqja 708 ha, 7% e sipërfaqes së territorit të Bashkisë.
4. Tjetra, sipërfaqja 17.693 ha, 73.6% e sipërfaqes së territorit të Bashkisë.

Nenzonat e ndara sipas funksioneve baze:

1. Zona urbane.
  - 1.1 Nenzona e parcelave ndertimore për banim, sipërfaqja 406 ha, 69.5% e sipërfaqes të territorit të zones.
  - 1.2 Ndertesa banimi brenda zones urbane pafshatrat e braktitura sipërfaqja 1100 m<sup>2</sup>.
  - 1.3 Rruge brenda zones urbane sipërfaqja 7.7 ha.
2. Zona bujqësore, sipërfaqja 1405 ha, 14% e sipërfaqes së territorit.
3. Zona natyrore pyje kullota, sipërfaqja 708 ha, 7% e sipërfaqes së territorit.
  - 3.4 Shkurre e rralle sipërfaqja 31.80 ha, 15.5% e sipërfaqes së zones pyje, kullota.
  - 3.5 Kullote sipërfaqja 458,2 ha, 31.5% e sipërfaqes së zones pyje, kullota.

Sipas Ligjit nr 115/ 2014, "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", Njësi Administrative Bashkia Pustec quhet zona urbane që zinte Komuna Liqenas përpara ndarjes së re territoriale. Po sipas këtij ligji, Njësi Administrative të tjera, quhen zonat sipas Tabelës , të cilat ishin komuna përpara ndarjes së re territoriale.

**-Ndarja në Fshatra të Bashkisë Pustec:**

Nr	Bashkia Pustec	Lagje / Fshatra
1	Pustec	
2	Zaroshkë	
3	Lajthizë	
4	Cerje	
5	Diellas	
6	Gllomboc	
7	Kallamas	
8	Gorice e Madhe	
9	<b>Gorice e Vogel</b>	

## **I.TAKSAT VENDORE**

**I.1. Tatim i thjeshtuar mbi biznesit e vogël ( Eshtë e ardhur që mblidhet nga pushteti qëndror dhe me aktrakordim behët kalimi ne pushtetin vendor për pjesen që i takon)**

### **I.2. Taksa mbi pasurinë e paluajtshme**

Taksës mbi pasurinë e paluajtshme i nënshtrohen të gjithë personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, pronarë apo përdorues të pasurive të mësipërme, në territorine e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre pasurive. Bëjnë përjashtim rastet kur në ligj parashikohet ndryshe. Detyrimin për taksën mbi pasurinë e paluajtshme e ka, sipas rastit, pronari ose bashkëpronari, sipas pjesës që zotëron, apo përdoruesi i pasurisë së paluajtshme, për pasuritë që nuk janë të pajisura me dokumente pronësie.

Në taksat mbi pasurinë e paluajtshme përfshihen:

- Taksa mbi ndërtesën
- Taksa mbi tokën bujqësore
- Taksa mbi truallin

Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë (ndërtesë, tokë bujqësore, truall) përdoruesi i pasurisë bën një vetëdeklarim të sipërfaqes pranë Bashkisë. Bashkia nëpërmjet komisionit të ngritur mund të vlerësojë sipërfaqen e taksueshem.

## 2.1 Taksa mbi ndërtesat

Llogaritja e taksës së ndërtesës është bërë në mbështetje të V.K.M 132, datë 07.03.2018 “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa” baza e taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe kriterëve dhe rregullave për vlersimin e detyrimit të taksës “neni 2 pika 3 ku thuhet:

Njësitë e qeverisjes vendore mund të miratojnë nëndarje zonale/nënzonale brenda territorit, brenda juriduksionit të tyre për zbatimin e nivelit të shkallës së taksës plus 30 (tridhjet) përqind ose minus 30 (tridhjet) përqind.

**"Çmim vlerësues"**, njësi matëse e vlerës për metër katror të sipërfaqes së ndërtimit të pasurisë së paluajtshme. Ky çmim mund të jetë çmimi i tregut ose çmimi i vlerësuar.

**"Ndërtesë"**, objekti/objektet e ndërtuara mbi/nën sipërfaqen e tokës ose të lidhura me tokën dhe që përfaqëson një strukturë ndërtimore me një ose më shumë njësi pronësore, e cila është objekt i taksës mbi ndërtesën sipas përcaktimit të dhënë në ligj.

**"Ndërtesë e papërfunduar"**, objekti ndërtimor në tërësi ose/edhe ajo pjesë e ndërtesës ekzistuese, për të cilin zhvilluesi është pajisur me leje ndërtimi, por që nuk ka arritur ta përfundojë atë sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.

**"Njësi pronësore"**, ndërtesa ose pjesë e saj, e cila është në pronësi/përdorim të individit, të një personi fizik apo të një personi juridik, dhe që është e ndarë ligjërisht nga pronat e tjera të pasurisë së paluajtshme "ndërtesë". Njësi pronësore mund të përdoret për qëllim banimi ose/edhe për qëllim veprimtarie ekonomike etj.

**"Ndarje e njësisë pronësore për banim"**, pjesa e njësisë pronësore që përdoret për qëllim banimi.

**"Ndarje e njësisë pronësore për veprimtari ekonomike"**, pjesa e njësisë pronësore që përdoret për qëllim veprimtarie ekonomike.

**"Përdorues"**, individ, personi fizik ose personi juridik, që ka në përdorim ndërtesën njësinë pronësore për qëllime banimi, veprimtarie ekonomike apo për veprimtari joekonomike, pavarësisht nga fakti nëse kjo ndërtesë/njësi pronësore ka titull pronësie ose jo.

**"Taksapagues"**, çdo individ, person fizik ose juridik, vendës ose i huaj, pronar apo përdorues i pasurive të paluajtshme në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre ndërtesave. Detyrimin për pagimin e taksës mbi pasurinë e paluajtshme "ndërtesë" e kanë, sipas rastit, pronari ose bashkëpronari, sipas pjesës që zotëron, apo përdoruesi i pasurisë së paluajtshme, për pasuritë që nuk janë të pajisura me dokumente të pronësisë, personat që kanë aplikuar për legalizim të ndërtesës, zhvilluesit, të cilët nuk arrijnë të mbyllin ndërtimin sipas lejes përkatëse të lëshuar nga njësi e vetëqeverisjes vendore.

**"Vlerë e pasurisë"**, vlera e pasurisë është baza e taksueshme mbi të cilën aplikohet shkalla e taksës së pasurisë së paluajtshme ndërtesë/njësi pronësore. Vlera e pasurisë llogaritet si shumëzim i çmimit për metër katror me sipërfaqen e ndërtesës/njësisë pronësore.

**"Veprimtari ekonomike"**, çdo veprimtari e kryer nga prodhuesit, tregtarët, personat që furnizojnë mallra dhe shërbime, përfshirë veprimtaritë nxjerrëse, industriale, tregtare, të shërbimit, bujqësore dhe veprimtaritë profesionale. Veprimtari ekonomike konsiderohet, gjithashtu, shfrytëzimi i pasurisë së trupëzuar ose të patrupëzuar, me qëllim realizimin e të ardhurave me karakter të vazhdueshëm.

- Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen individët, personat fizikë ose juridikë, vendas apo të huaj, pronarë ose përdorues të pasurive të paluajtshme në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre ndërtesave, përveç rasteve kur në ligj përcaktohen ndryshe.
- Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen personat që kanë aplikuar për legalizim të ndërtesës, sipas ligjit "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje".
- Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen zhvilluesit, të cilët nuk arrijnë të mbyllin ndërtimin sipas lejes përkatëse, të lëshuar nga autoriteti i planifikimit. Afati i përllogaritjes së taksës fillon nga momenti i mbarimit të afatit kohor të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.
- Detyrimi për taksën mbi ndërtesat llogaritet si shumëzim i bazës së taksës me shkallën e taksës mbi ndërtesën.
- Taksa vendore mbi pasurinë e paluajtshme-ndërtesë llogaritet si detyrim vjetor i taksapaguesit. Pagesa e taksës bëhet çdo muaj apo për periudha më të gjata, në varësi të kategorisë së taksapaguesit.
  - Çmimi mesatar referues i shitblerjes së ndërtesave që përdoren për qëllim banimi për Bashkinë Pustec është **35000 lekë/m<sup>2</sup>**.
  - Çmimet mesatare për metër katror sipërfaqe ndërtimi për ndërtesat që nuk shërbejnë për banim janë si më poshtë vijon:
    - Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për veprimtari tregtimi dhe shërbimi është 1.5 (një pikë pesë) here më i lartë se çmimi i sipërfaqeve të banimit sipas qyteteve. Në këtë kategori do të përfshihen edhe ndërtesa tregtare, ku njëkohësisht realizohen edhe procese të përziera prodhim, tregtim ose/edhe shërbimeme pakicë.
    - Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për parkim të mbuluar dhe bodrume është 70 (shtatëdhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqeve të apartamenteve të banimit sipas qyteteve.
    - Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për parkim të hapur është 30 (tridhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqeve të apartamenteve të banimit në qytet.
    - Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi të destinuara për veprimtari industriale, si: prodhim, përpunim ose magazinim të mallrave industriale, duke përfshirë fabrikat, depot, magazinat dhe objektet e tjera të ngjashme, është 50 (pesëdhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqeve të banesave të zonës përkatëse.
    - Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi që përdoren për bujqësi dhe blegtori apo veprimtari mbështetës, si grumbullim, magazinim dhe ruajtje të produkteve bujqësore dhe blegtorale është 30 (tridhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqeve të banesave të zonës përkatëse, me përjashtim të përpunimit ushqimor.
    - Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi të destinuara për banim në njësitë administrative jashtë qytetit, të cilat iu bashkuan njësitë të vetëqeverisjes vendore pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 115/2014, reduktohet deri në 35 (tridhjetë e pesë) për qind, krahasuar me çmimin e zonës më të afërt, përjashtuar zonat rezidenciale.
    - Për ndërtesat e privatizuara me ligjin nr. 7652, datë 23.12.1992, "Për privatizimin e banesave shtetërore", të ndryshuar, çmimi për metër katror është 70 (shtatëdhjetë) për qind e çmimit, vetëm në rastin e shitjes së parë.

### **Shkalla e taksës mbi ndërtesat:**

Shkalla e taksës mbi ndërtesat, e cila aplikohet si përqindje e bazës së taksës, është si më poshtë:

- a) 0,05% për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për banim;
- b) 0,2% për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike;
- c) 30% e shkallës së taksës përkatëse për të gjithë sipërfaqen ndërtimore, për të cilën

zhvilluesi është pajisur me leje ndërtimi dhe nuk ka arritur ta përfundojë atë sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.

Për ndërtesat në pronësi të shoqërive të ndërtimit, të destinuara për shitje, por që janë ende të pa shitura, taksa do të vendoset sipas destinacionit të përdorimit të ambientit të ndërtesës.

Ambiente të hipotekuara si:

- Apartamente banimi do të nënshtrohen taksës mbi ndërtesat në kategorinë “*ndërtesa që përdoret,shfrytëzohet për banim*”.
- Njësi biznesi do të nënshtrohen taksës mbi ndërtesat në kategorinë “*ndërtesa që përdoret,shfrytëzohet për veprimtari ekonomike*”.
- Bodrum/parking i mbuluar do të nënshtrohen taksës mbi ndërtesat në kategorinë “*ndërtesa që përdoret për parkim të mbuluar dhe bodrume*”.

Për sa i përket kategorisë ndërtesa që përdoret, shfrytëzohet për banim nëse identifikohet ekzistenca, por nuk arrihet të përcaktohet sipërfaqja e ndërtesës/njesisë pronësore, përdoren vlerat referuese për sipërfaqe, si më poshtë vijojnë:

**a)** 100 (njëqind) metër katror sipërfaqe për njësi pronësore, për ndërtesat për banim;

**b)** 70 (shtatëdhjetë) metër katror sipërfaqe për njësi pronësore, për ndërtesat për banim, të privatizuara me ligjin nr. 7652, datë 23.12.1992, "*Për privatizimin e banesave shtetërore*", të ndryshuar.

Për sa i përket kategorisë ndërtesa që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike nëse identifikohet ekzistenca, por nuk arrihet të përcaktohet sipërfaqja e ndërtesës/njesisë pronësore, njësitë e vetëqeverisjes vendore bëjnë verifikimin në terren, për të përcaktuar sipërfaqen dhe për të llogaritur bazën e taksës.

Llogaritja e taksës së ndërtesës është bërë në mbështetje të V.K.M nr 132, datë 07.03.2018 “ Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, baza e taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe regullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës” nenit 2 pika 3 ku thuhet:Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të miratojnë nënndarje zonale/nënzonale të territorit,brenda juridiksionit të tyre, për zbatimin e niveleve të shkallës së taksës brenda kufijve plus 30 (tridhjetë)për qind ose minus 30 (tridhjetë) për qind. Këshilli i njesisë së vetëqeverisjes vendore, jo më shpesh se një herë në vit, për banesat në njësitë administrative jashtë qytetit përkatës, të cilat iu bashkuan njësive të qeverisjes vendore pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 115/2014, mund të reduktojë çmimin mesatar

referues të përcaktuar në aneksin 1, deri në masën minus 35 (tridhjetë e pesë) përqind, krahasuar me çmimin e zones më të afërt, përjashtuar zonat rezidenciale.

## Kjo taksë miratohet pa ndryshim si në vitin 2024.

### 1.Taksa e ndërteses për qellim banimi në të gjithë fshatrat e Bashkisë Pustec:

<b>Emertimi</b>	<b>Vlera ne lekë/m<sup>2</sup> sipas Ligjit 106/2017</b>	<b>Propozuar -30 % mbi shkallën e taksës</b>	<b>Miratuar</b>
<b>Banasa</b>	17.5 (35000*0.05%)	12.25 lekë/m <sup>2</sup> (17.5*70%)	12.25 lekë/m <sup>2</sup>

### 2.Njesi tregtimi dhe sherbimi

Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për veprimtari ekonomike tregtimi shërbimi është 1.5(një pikë pesë) herë më i lartë se çmimi i sipërfaqeve të banimit sipas qyteteve.

<b>Emertimi</b>	<b>Vlera ne lekë/m<sup>2</sup> sipas Ligjit 106/2017</b>	<b>Propozuar +30 % mbi shkallën e taksës</b>	<b>Miratuar</b>
<b>Njesi tregtimi dhe sherbimi</b>	105 (52500*0.2%)	136.5 lekë/m <sup>2</sup> (105*130%)	136.5 lekë/m <sup>2</sup>

### 3.Veprimtari bujqesore dhe blegtorale

Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi që përdoren për bujqesi dhe blektori është 30(tridhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqeve të banesave të zonës përkatëse

<b>Emertimi</b>	<b>Vlera ne lekë/m<sup>2</sup> sipas Ligjit 106/2017</b>	<b>Propozuar +30 % mbi shkallën e taksës</b>	<b>Miratuar</b>
<b>Veprimtari bujqesore dhe blegtorale</b>	21 (10500*0.2%)	27.3 lekë/m <sup>2</sup> (21*130%)	27.3 lekë/m <sup>2</sup>

### 4.Parkime te mbyllura dhe bodrume

Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për parkim të mbuluar dhe bodrume është 70(shtatëdhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqeve të apartamenteve të banimit sipas qyteteve.

<b>Emertimi</b>	<b>Vlera ne lekë/m<sup>2</sup> sipas Ligjit 106/2017(taksa behet)</b>	<b>Propozuar +30 % mbi shkallën e taksës</b>	<b>Miratuar</b>
<b>Parkime te mbyllura</b>	49 (24500*0.2%)	63.7 lekë/m <sup>2</sup> (49*130%)	63.7 lekë/m <sup>2</sup>

## 5.Parkim i hapur ne Bashki

Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për parkim i hapur,pishinë e hapur,ambiente sportive te hapura, te tilla si:fusha futbollit, minifudboll,basketboll,volejbollit,tenisi,golfi,pista per gara te ndryshme te atletikes,motorike ,gara me kuaj e tjera te ngjashme me to: porte dhe aeroporte te cdo kategorie, per te gjithë siperfaqaqen e shtrire qe ato zene, është 30(tridhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqeve të banesave.

<i>Emertimi</i>	<b>Vlera ne lekë/m<sup>2</sup> sipas Ligjit 106/2017(taksa behet)</b>	<b>Propozuar +30 % mbi shkallën e taksës</b>	<b>Miratuar</b>
<i>Parkime te hapura</i>	21 (10500*0.2%)	27.3 lekë/m <sup>2</sup> (21*130%)	27.3 lekë/m <sup>2</sup>

## 6.Veprimtari industrial ne Bashki.

Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për veprimtari industriale te tilla si:prodhim,perpunim apo magazinim te lendeve te para ,te gjysem produkteve apo te produkteve te gatshme industriale ,si : fabrika ,magazina,depo,magazina frigoriferike te produkteve ushqimore(perjashtur ato te njesive te tregtimit dhe sherbimit) është 50(pesëdhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqeve të banesave.

<i>Emertimi</i>	<b>Vlera ne lekë/m<sup>2</sup> sipas Ligjit 106/2017(taksa behet)</b>	<b>Propozuar +30 % mbi shkallën e taksës</b>	<b>Miratuar</b>
<i>Veprimtari industrial ne Bashki</i>	35 (17500*0.2%)	45.5 lekë/m <sup>2</sup> (35*130%)	45.5lekë/m <sup>2</sup>



### Perjashtohen nga pagesa e taksës së ndertesës

- a) Pronat e shtetit dhe të njëjve të qeverisjes vendore që përdoren për qëllime jofitimprurëse;
- b) Ndërtesat e banimit që shfrytëzohen nga qirramarësit me qira të paliberalizuara;
- c) Ndërtesat që përdoren nga komunitetet fetare, në funksion të veprimtarisë së tyre;
- ç) Pasuritë në pronësi të shtetit, të kaluara me vendim të Keshillit të Ministrave, nën administrimin e shoqerive publike shtetërore;
- d) Banesat sociale në pronësi të Bashkive;
- dh) Pasuritë e paluajtshme – ndërtesa, prone e subjekteve juridike ose fizike, që në bazë të marrëveshjeve me bashkitë përdoren nga këto të fundit banesa sociale;
- e) Strukturat akomoduese “ Hotel /Resort me kater dhe pese yje, status special “, sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtes të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht “ *brand name*”;
- ë) Ndërtesat e banimit të deklaruara si vendbanim nga kryefamiljarët që përfitojnë pension pleqërie ose pension social, që janë me banim në fshat ose qytet, kur familja përbehet vetëm nga pensionistë ose dhe me persona në ngarkim të tyre, që janë të paaftë për punë ;
- f) Ndërtesat e banimit të kryefamiljareve që trajtohen me ndihmë ekonomike;
- g) Ndërtesat kulturore, nën mbrojtje të perkohshme ose të perhershme, për kohën në të cilën deklarohet mbrojtja, sipas legjislacionit në fuqi për monumentet e kultures dhe/ose trashëgiminë kulturore, të cilat përdoren vetëm për qëllime jo fitimprurëse.

### Afati i pagesës

Detyrimi vjetor për kategorinë ndërtesa që përdoret , shfrytëzohet për banimi do të shpërndahet në periudhën Janar – Qershor 2025 ,dhe detyrimi vjetor për taksën mbi\_ndertesës do të paguhet pranë Arkës e Bashkisë brenda vitit 2025.

Detyrimi vjetor për kategorinë ndërtesa për qellim biznesi do të shpërndahet në periudhën Janar - Mars 2025 pagesa do të bëhet brenda datës 30.09.2025.

Tatimpaguesi , i cili nuk arinë që brenda afatit të parashikuar ,te paguajë shumën e detyrimit tatimor të kontributit , detyrohen të paguajnë një gjobë të barabartë me 0.06 % përqind të shumës së detyrimit të papaguar të çdo ditë,gjatë së cilës pagesa nuk është kryer.Në asnjë rastë, gjoba nuk llogaritet më shumë se 365 ditë kalendarike.Përjashtohen nga pagesa e gjobës për vones në pagesë të gjithë taksapaguesit familjarë.

**Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës së ndertesës , është Zyra e Tatim-Taksave pranë Bashkisë Pustec.**

## 2.2 Taksa mbi tokën bujqësore

**Baza e taksës:** Është sipërfaqja e tokës bujqësore, në hektar, në pronësi apo në përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e tokës përcaktohet mbi bazën e dokumentave të pronësisë, formularit nr.6, aktit të pronësisë, çertifikatës së regjistrimit të tokës.

**Niveli i taksës mbi tokën bujqësore paraqitet si më poshtë:**

Kategorite mesatare të tokës Bujqësore	Njesia	Vlera e taksës Sipas Ligjit	Propozuar vlera e taksës se propozuar - 30%	Miraturar
<b>IV</b>	lekë/ha/vit	2300	1610	<b>1610</b>
<b>V</b>	lekë/ha/vit	1900	1330	<b>1330</b>
<b>VI</b>	lekë/ha/vit	1600	1120	<b>1120</b>
<b>VI I-X</b>	<b>lekë/ha/vit</b>	<b>1400</b>	<b>980</b>	<b>980</b>

### Përjashtime:

Përjashtohen nga taksa mbi tokën bujqësore , që mbillen me kultura drufrutore dhe vreshtari për pesë vitet e para nga çasti i mbjelljes. Ngarkohet Sektori i Bujqësisë , për vlersimin e kategorisë së tokës si dhe saktësimin dhe verifikimin e periudhës së mbjelljes me kultura drufrutore dhe vreshtari ,për çdo fermer/fermë

**Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi tokën bujqësore , për të gjitha kategoritë është Zyra e Tatim-Taksave pranë Bashkisë Pustec.**

## 2.3 Taksë mbi truallin

Baza e taksës mbi truallin është sipërfaqja e truallit, në metër katror, në pronësi apo përdorim të taksapaguesit dhe është detyrimi vjetor i taksapaguesit.

Kategoritë minimale të bazës së taksës dhe niveli tregues të taksës për çdo kategori minimale të bazës për taksën mbi truallin është si vijon:

<b>Bashkia</b>	<b>Vlera e taksës në lekë/m<sup>2</sup>/vit për qellime banimi</b>	<b>Vlera e taksës në lekë/m<sup>2</sup>/vit për qellime Biznesi</b>
<b>Bashkia Pustec</b>	<b>0.14 lekë/m<sup>2</sup></b>	<b>12 lekë/m<sup>2</sup></b>

### Afati i pageses

Detyrimi vjetor për kategorinë truall për qellime banimi nga individet do të shpërndahen në periudhen Janar - Qershor 2025 ,dhe detyrimi vjetor për takasën mbi truallin do te paguhet pranë Arkes e Bashkisë Pustec brenda vitit 2025.

Detyrimi vjetor për kategorinë truall për qellim biznesi do të shpërndahen ne periudhën Janar - Mars 2025 pagesa do te behet brenda datës 30.09.2025.

Tatimpaguesi , i cili nuk arinë që brenda afatit të parashikuar ,te paguajë shumën e detyrimit tatimor të kontributit , detyrohen të paguajnë nje gjobë te barabartë me 0.06 % perqind të shumës se detyrimit të papaguar të çdo ditë,gjatë së ciles pagesa nuk është kryer.Në asnje rasë, gjoba nuk llogaritet më shumë se 365 ditë kalendarike.Përrjashtohen nga pagesa e gjobës për vones në pagesë të gjithë taksapaguesit familjarë.

### I.3.Taksa e fjetjes në hotel

Përkufizimi: Strukturat akomoduese dot të përfshijnë kategoritë si mëposhtë:

a)“Bujtinë”; b)“Fjetinë” (Hostel); c)“Kamping”; ç)“Hotel”; d)“Motel”; d)“Resort”; e)“Qendër kurative”; ë)“Fjetje dhe mëngjes”(B&B).

Secila kategori e strukturave akomoduese klasifikohet me sistem të veçantë, shoqëruar me shenjat dalluese përkatëse, sipas përcaktimit të mëposhtëm: “Bujtinë”Standard. Baza e taksës: Është numri i netëve të qëndruara në hotel për person.

#### **Niveli i taksës se fjetjes në hotel paraqitet si më poshtë:**

Emertimi i kategorive dhe Nënkatgorive		Niveli i taksës së fjetjes në hotel në Bashkisë Pustec	
Taksa e fjetjes në Hotel	Njësia	Sipas ligjit	Miratuar
<b>Hotel me 4-5 yje</b>	lekë/natë qëndrimi/për person	105	<b>105</b>
<b>Bujtinë, fjetinë, motel dhe çdo njësi tjetër akomoduese, sipas përcaktimevetëligjit për turizmin</b>	<b>lekë/natë qëndrimi/për person</b>	<b>35</b>	<b>35</b>

Detyrimi për pagesën e taksës së fjetjes në hotel dhe kështu e pagimit: Detyrimi për taksën llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës së vendosur nga bashkia, për natë , me numurin e netëve të qëndrimit në hotel.

Detyrimi për taksën i takon klientit që streohet në hotel,detyrimi i cili mbahet nga hoteli për llogaritë e Bashkisë në te cilen ndodhet hoteli.Në faturën e hotelit shënohet çmimi i fjetjes mbi të vlera e taksës.

**Struktura për vjeljen e taksës:** Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës së fjetjes në hotel është Zyra e Tatim-Taksave.

#### **I.4.Të miratojë Taksën e Ndikimit në Infrastruktura nga Nderimet e Reja si dhe nivelin e saj sipas kategorive dhe nenkategorive të investimeve si më poshtë:**

##### **I.4.- TAKSA E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË NGA NDËRTIMET E REJA**

1.Baza e taksës është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet ose vlera në lekë e çmimit të shitjes për metër katror të investimit të ri. Klasifikimi si investim i ri përcaktohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për dhënien e lejes së ndërtimit.

2.Në rastin e ndërtimeve për qëllime banimi apo njësi shërbimi nga shoqëritë e ndërtimit, të cilat nuk destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, industrisë apo përdorim publik, taksa e ndikimit në infrastrukturë do të jetë 4 për qind të çmimit të shitjes për metër katror për qytetin dhe për njësitë administrative taksa e ndikimit në infrastrukturë do të jetë 4 për qind të çmimit të shitjes për metër katror. Për banesat e ndërtuara nga Enti Kombëtar i Banesave për strehimin e familjeve të pastreha, pavarësisht nga zona ku ndërtohet, taksa e ndikimit në infrastrukturë do të jetë 4 për qind të çmimit të shitjes për metër katror. Baza e taksës është vlera në lekë për metër katror sipas preventivit ose çmimit të shitjes së njërive të shërbimit apo ndërtesave për qëllime banimi. Çmimi i shitjes për metër katror bazohet në vlerën referuese të vlerës së tregut, sipas përcaktimeve në udhëzimin e Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave”, që miratohet çdo vit.

3.Në rastin e ndërtimeve të ndryshme nga ato të përcaktuara në pikën 2, niveli i taksës shprehet si përqindje e vlerës së investimit do të jetë 3 për qind e kësaj vlere. Në këtë rast përfshihen edhe investimet për ndërtime që shërbejnë për banim të realizuar nga vetë investitori dhe që destinohen për përdorim vetiak të investitorit dhe jo për qëllime shitjeje, pavarësisht se ky ndërtim realizohet me shoqëri ndërtimi apo nga vetë investitori.

4.Për projektet e infrastrukturës, për ndërtimin e rrugëve kombëtare, të porteve, aeroporteve, tuneleve, digave, ndërtimit të infrastrukturës në energji, përfshirë makineritë dhe pajisjet për këto projekte, taksa e ndikimit në infrastrukturë të ndërtimeve të reja është 0,1 për qind e vlerës së investimit, por jo më pak se kostoja e rehabilitimit të infrastrukturës së dëmtuar, kur kjo kosto nuk është përfshirë në preventivin e investimit.

5.Për ndërtesat, të cilat janë në proces legalizimi, taksa e ndikimit në infrastrukturë e ndërtimeve të reja është 0,5 për qind e vlerës së investimit. Për ndërtime në proces legalizimi, objekt i dytë, taksa e ndikimit në infrastrukturë do të llogaritet si ndërtime të reja që trajtohen me leje ndërtimi (Pika 2 dhe 3).

6.Detyrimi për pagesën e taksës i takon investitorit.

7.Nëse objekti, për të cilin do të bëhet investimi, shtrihet në territorin e më shumë se një bashkie ose kur objekti ndikon në infrastrukturën e një bashkie tjetër, të ardhurat nga taksa ndahen proporcionalisht ndërmjet tyre, në përputhje me raportet përkatëse të shtrirjes së objektit dhe të ndikimit të investimit në infrastrukturën e secilës bashki.

8.Pagesa e taksave do të kryhet pas miratimit të vendimit dhe zbardhjes së tij por jo më vonë se 15 ditë.

**Struktura e ngarkuar për përlogaritjen, vjeljen dhe lëshimin e autorizimit për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtime të reja, është Sektori i Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit pranë Bashkisë Pustec.**

### I.5. Taksamb i kalimit të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme

**Baza e taksës** mbi kalimin e së drejtës së pronësisë *për ndërtesat* është sipërfaqja e ndërtimit, pronësia e së cilës transferohet. Baza e taksës për kalimin e së drejtës së pronësisë *për pasuritë e tjera të paluajtshme* është vlera e shitjes së tyre. Niveli i taksës përcaktohet në përqindje dhe niveli i tregues i taksës është **2 për qind**. Detyrimi tatimor llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tij.

Niveli i taksës:

Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme vendoset në çastin e kalimit të së drejtës së pronësisë mbi to.

Niveli i Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme është paraqitur si mëposhtë:

Emertimi i kategorive dhe nënkategorive	Njësia	Bashkia Pustec
		<b>Sipas ligjit</b>
<b>Ndërtesa banimi</b>	Lekë/m <sup>2</sup>	<b>100</b>
<b>Ndërtesat e tjera për tregti dhe Shërbime</b>	Lekë/m <sup>2</sup>	<b>300</b>
<b>Ndërtesa të tjera</b>	Lekë/m <sup>2</sup>	<b>200</b>

**Vjelja e kësaj takse bëhet nga Zyra e Pasurive të Paluajtshme në rolin e agjentit tatimor .**

### I.6. Garanci financiare për subjektet fizike/juridike, kërkues i lejes për ndërtimin, riparimin, restaurimin apo shembjen e objektit:

**Garancia financiare:** Në mbështetje të pikës 10 të VKM-se Nr. 575, datë 24.6.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”, subjekti fizik/juridik, kërkues i lejes për ndërtimin, riparimin, restaurimin apo shembjen e objektit, përpara marrjes së lejes së ndërtimit duhet të depozitojë një garanci financiare për llogaritë të Bashkisë, e cila nuk do të jetë më e vogël se 3% e vlerës së strukturës së objektit dhe përcaktohet me vendim të këshillit të Bashkisë.

Bashkia, më konkretisht Drejtoria e Kontrollit të zhvillimit të territorit, në dokumentacionin e lëshimit të lejes për projektin e ndërtimit, riparimit, restaurimit apo shembjes, përcakton nëse personi fizik ose juridik, të cilit i është dhënë leja për realizimin e projektit, duhet të provojë me dokumentacionin e nevojshëm përmbushjen e kërkesave sipas VKM Nr. 575, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e përfundimit të projektit të ndërtimit, riparimit, restaurimit apo prishjes së objektit, i cili krijon mbetje inerte.

